

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3383 prot.

Tiranë, më 09.09.2024

Lënda: Dërgimi i shkresës së Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar

Z. ROBERT GAJDA
KOMISIONER PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

I nderuar z. Gajda,


Ju lutem gjeni bashkëlidhur shkresën e Z. Fatmir Xhafaj, Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Genci Gjonçaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

Nr. 3383 Prot.

Tiranë, më 09.09.2024

Lënda: Ftesë për bashkëpunim

Z. ROBERT GAJDA
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Tiranë

I nderuar z. Gajda,

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 27.5.2024, miratoi Rezolutën “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, dhe në zbatim të saj me Vendimin Nr. 50/2024 ka miratuar ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” (“Komisioni i Posaçëm Parlamentar”) dhe në vijim me Vendimin Nr. 53/2024 ka përcaktuar përbërjen e këtij Komisioni.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar në mbledhjen e tij të datës 14.06.2024 vendosi t’ju drejtohet me një “*Ftesë për bashkëpunim*”, disa prej Institucioneve të Pavarura, funksionet e të cilave lidhen me qëllimin e Rezolutës së Kuvendit dhe objektin e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në këto tre fusha, i) mirëqeverisja, ii) antikorrupsioni dhe iii) sundimi i ligjit.

Bazuar në këtë vendimmarrje të komisionit, kam kënaqësinë t’i drejtohem Institucionit tuaj, duke ju ftuar të bëheni pjesë e këtij procesi dhe të jepni kontributin tuaj me ekspertizë konkrete, duke u përfaqësuar me ekspertë me përvojë të spikatur pranë Grupeve të Ekspertëve ose me ekspertë më të rinj pranë Sekretariatit Teknik, struktura që do të ngrihen pranë këtij komisioni dhe prej të cilave do të hartohen aktet dhe dokumentat që do ti prezantohen Komisionit të Posaçëm Parlamentar për shqyrtim e miratim.

Duke vlerësuar rolin dhe kontributin tuaj ndër vite në këto fusha në ushtrim të funksionit tuaj kushtetues e ligjor, shprehim gjithashtu interes të veçantë për tu njohur me të dhëna dhe dokumenta të ndryshme të hartuara nga institucioni juaj në 5 vitet e fundit, për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij komisioni, të cilat do të na shërbenin për i) procesin e analizës,

ii) hartimin e strategjisë e planit të veprimit si dhe iii) propozimet e mundshme për ndryshime ligjore sipas objektit të punës së këtij komisioni, përcaktuar nga Kuvendi.
Për sa më sipër, do të vlerësonim prezencën e ekspertizës tuaj, ndaj mirëpresim me shumë interes propozimet tuaja konkrete për ekspertë dhe informacione në nivel institucioni, të cilat mund të na i dërgoni në adresën elektronike: KomisioniPosacem@parlament.al, mundësisht brenda datës 16.09.2024.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin, për sa më sipër, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratë,

Kryetari i Komisionit

Fatmir Xhafaj

